



Pranuar / Doretuar Priljena/Prodato Received/Delivery	10.06.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojti a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3012/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.313/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani -anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 28.04.2021 me numër A.nr.313/2021 të parashtruar nga ankuesi

ne adresë lagjia Apollonia objekti i Preniqve, hymja e 2 nr. 18 në Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore-paralajmërim qortues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.313/2021 e datës 28.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET paralajmërimi qortues i datës 19.04.2021 përmes procesverbalit, i nxjerrë nga Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale në Prishtinë 3, në Administratën Tatimore të Kosovës.

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh të bëjë zbatimin e këtij vendimi, që ti fshihet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës për ankuesin, *paralajmërimi qortues i datës 19.04.2021 për mes procesverbalit*, i nxjerrë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë/ Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale në Prishtinë 3, në Administratën Tatimore të Kosovës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitë “Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit”, në Drejtorin Rajonale në Prishtinë, sipas Akte Emërimit të datës 03.09.2019 nr. Protokollit

08/56/09, me koeficient tetë pik pesë (8.5), të cilit me datë 19.04.2021, mbikqyrësi i drejtpërdrejtë-Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale në Prishtinë 3, e paralajmëron përmes procesverbalit- qortimit, për shkak të mos kryerjes së detyrave të punëve konform planit dinamik të punës të paraparë për vitin 2021 në Drejtorin Operative Rajonale në Prishtinë 3, me theks të veçantë vonesës së pa arsyeshme në përfundimin e kontrollave si në vijim: *Kontrolla te T/P Dani Company-ShPK NUI 810374950, kontratat e përfundimit të kësaj kontrole 21 muaj, dhe Kontrolli tek T/P Swiss General NUI 810799380 e hapur nga muaji 06/2020 e pa përfunduar ende.*

Ankuesi kundër paralajmërimit qortues të datës 19.04.2021 përmes procesverbalit, i cili me datë 28.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është njoftuar me kohë lidhur me dyshimin e mos kryerjes së punëve për mes E-mailit zyrtar duke bashkangjitur dhe raportin e punës të dorëzuar nga nëpunësit e tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore e Kosovës. Më datë 03.06.2021 Administrata Tatimore e Kosovës, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e regjistruar me datë 28.04.2021 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 2050/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbal paralajmërimi - qortim i datës 19.04.2021; Përgjigje në ankesë e datës 03.06.2021 nr. protokolli 2858/2021; Akt emërimi i datës 03.09.2019 me nr. Protokolli 11/02/56/09; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës; E-mail i datës 19.04.2021 paralajmërim qortim; E-mail i datës 19.04.2021 draft raport i kontrollit për Dani Company SHPK 810374950; E-mail i datës 19.04.2021 draft raport kontroll; E-mail i datës 15.04.2021 draft raport i kontrollit; Aktivitetet e planifikuara ditore të inspektorëve, data 19.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se është kundër paralajmërimit qortues të datës 19.04.2021 përmes procesverbalit të nxjerrë nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit gjegjësisht Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale në Prishtinë 3, për shkak të mos kryerjes së detyrave të punës, konform planit dinamik të punës të paraparë për vitin 2021, në Drejtorin Operative Rajonale në Prishtinë 3, i cili qortim paralajmërues është në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitë "Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit", në Drejtorin Rajonale në Prishtinë, sipas Akte Emërimit të datës 03.09.2019 nr. Protokolli 11/08/56/09, të cilit me datë 19.04.2021 i është shqiptuar paralajmërim qortues përmes procesverbalit nga Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale në Prishtinë 3 (mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit), për shkak të mos kryerjes së detyrave të punëve konform planit dinamik të punës të paraparë për vitin 2021, për vonesa të pa arsyeshme për përfundimin e kontroleve, si në vijim: *1. Kontrolla te T/P Dani Company-ShPK NUI 810374950, kontratat e përfundimit të kësaj kontrole 21 muaj, dhe 2. Kontrolli tek T/P Swiss General NUI 810799380 e hapur nga muaji 06/2020, e pa përfunduar ende.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se *paralajmërimi qortues përmes procesverbalit*, i nxjerrë me datë 19.04.2021 nga Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale në Prishtinë 3, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë, është në kundërshtim me ndarjen e shkeljes disiplinore, të përcaktuar në nenin 46 paragrafin 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta", sepse *paralajmërimi qortues përmes procesverbalit*, i emërtuar për ankuesin nuk është specifikuar si shkelje e lehtë as e rëndë por vetëm është dhënë arsytimi për mos kryerjen e detyrave të punëve konform planit dinamik të punës të paraparë për vitin 2021, për vonesa të pa arsyeshme për përfundimin e kontrolleve, që është në kundërshtim me masat disiplinore të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të njëjtit ligj, që përcaktohet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet", të cilat masa specifikohen dhe në Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik.

Lidhur me faktin se këto masa shqiptohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë që ka kompetencë të përcaktuar në nenin 48 paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", që në rastin konkret shqiptimi i masës disiplinore "paralajmërimi qortues përmes procesverbalit", për ankuesin nuk është e paraparë si masë e tillë dhe nuk është e përcaktuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, të cekura më lartë, si dhe duke u lidhur me neni 4 paragrafin 1 dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: neni 4 paragrafi 1. "Procedura disiplinore përfshin procedurën administrative, që kryhet nga marrja në dijeni për një shkelje disiplinore, deri në marrjen e një mase disiplinore nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë....." dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të njëjtës rregullore ku përcaktohet se: "1. Shkeljet disiplinore ndahen në:1.2. shkelje të lehta", e cila rregullore është aprovuar me datë 21.08.2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që specifikon procedurat disiplinore dhe kompetencat e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, të nëpunësve civil, në pajtim Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, me rastin e marrjes në dijeni për një shkelje disiplinore deri në marrjen e një mase disiplinore nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, i cili ligj ka hy në fuqi me datë 09.07.2020 dhe është i zbatueshëm, sipas Aktgjykimit nr. KO203/19, të Gjykatës Kushtetuese.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e ankuesit do të duhej të merrte për bazë kompetencën e tij, nëse konstaton se është në dijeni për një shkelje disiplinore në pajtim me dispozita ligjore të cekuar si më lartë, si dhe në pajtim me nenin 46 paragrafi 1 nën paragrafi 2.2, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe neni 5 Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohen ndarja e shkeljeve disiplinore për nëpunësit civil, që lidhen me shkeljet e lehta disiplinore në bazë të kompetencës ligjore të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

Andaj, mbi këtë bazë obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që ankuesit ti fshijë nga dosja personale, *paralajmërimin qortues të datës 19.04.2021*, e evidentuar përmes procesverbalit dhe i nxjerrë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë/ Drejtori i Drejtorisë Operative Rajonale

në Prishtinë 3, në Administratën Tatimore të Kosovës, duke obliguar Njësinë e personelit në Administratën Tatimore të Kosovës, të veprojë në pajtim me nenin 51 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: "2. Deklarimi i shuarjes bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësive së burimeve njerëzore të institucionit. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.313/2021, datë 10.06.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

